



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja **d**, të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), nenit 24, paragrafët 1, 2, dhe nenit 25, paragrafët 1, 2, dhe 6 të Ligjit nr. 06/L-092, për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 10/03, prill 2019), dhe të nenit 33.2, shkronja **a**, dhe nenit 34.1, shkronja **d**, të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 14.06.2021, merr këtë

V E N D I M

- I. **MIRATOHET** propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Tahir (Liman) Sylejmanit dhe Jahir (Liman) Sylejmanit.
- II. Prona e paluajtshme komunale që do të jepet në këmbim, ka këto karakteristika: pjesë e parcelës kadastrale nr. 01947-0, me sip. 50m², Zona kadastrale Prishtinë, Certifikata e pronësisë nr. P-71914059-01947-0, me destinim ndërtim sipas Planit rregullues "Prishtina e Re - Zona Perëndim", i miratuar me vendimin, nr. 01, nr. 35-186850, dt. 02.10.2013, kurse prona e paluajtshme që merret nga ky këmbim, është parcela kadastrale nr. 01788-2, sip. 50m², Zona kadastrale Prishtinë, Certifikata e pronësisë nr. P-71914059-01788-2, në pronësi të Tahir dhe Jahir Sylejmanit, me destinim rrugë e planifikuar sipas planit rregullues "Prishtina e Re - Zona Perëndim", i miratuar me Vendimin nr. 01, nr. 35-186850, dt. 02.10.2013.
- III. Këmbimi i pronës së paluajtshme është bërë pasi që nuk ekzistojnë parcela të tjera komunale të përshtatshme për realizimin e Planit rregullues "Prishtina e Re - Zona Perëndim", i miratuar me Vendimin nr. 01, nr. 35-186850, dt. 02.10.2013.
- IV. Para shpalljes publike të vendimit, do të bëhet vlerësimi i kualifikuar i vlerës së tregut të pronës së paluajtshme të Komunës dhe vlerësimi i pronës private, ku do të përcaktohen sipërfaqet e sakta të këmbimit.
- V. Mënyra dhe kushtet e këmbimit të pronës së paluajtshme do të përcaktohen me kontratë, e cila lidhet dhe nënshkruhet në mes të Kryetarit të Komunës dhe pronarit të parcelës kadastrale që do të këmbehet.
- VI. Pronat e paluajtshme komunale që do të këmbehen, të përshkruara në pikën II të këtij vendimi, duhet të evidentohen në librat kadastrale të Komunës.
- VII. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Pronës dhe Drejtoria e Kadastrit e Komunës së Prishtinës.

VIII. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

Arsyetim

Drejtoria e Urbanizmit në bazë të Vendimit 05. nr. 350/02-312807/21, dt 28.01.2021, ka dhënë pëlqimin për këmbimin e parcelës kadastrale nr. 1947-0, sip. 50m², Zona kadastrale, Prishtinë, Certifikata e pronësisë, nr. P-71914059-01947-0, në pronësi të Komunës së Prishtinës, me parcelën kadastrale 1788-2 me sip. 50m², ZK, Prishtinë, Certifikata e pronësisë, nr. P-71914059-01788-2, në pronësi të Tahir (Liman) Sylejmanit dhe Jahir (Liman) Sylejmanit, të cilat gjenden në kuadër të Planit rregullues "Prishtina e Re - Zona Perëndim", në Prishtinë.

Propozimi për inicimin e këmbimit të parcelës së tokës me pronarët e cekur në pikën II, është bërë për shkak të realizimit të Planit rregullues "Prishtina e Re - Zona Perëndim", në Prishtinë i miratuar me Vendimin nr. 01. nr. 35-186850, dt. 02.10.2013. Parcela nr. 1947-0, ZK, Prishtinë shtrihet në zonë të planifikuar për ndërtim, ndërsa parcela nr. 1788-2, ZK, Prishtinë shtrihet në rrugë të planifikuar sipas Planit rregullues "Prishtina e Re - Zona Perëndim", në Prishtinë.

Procedura e këmbimit të pronës komunale me pronë private, është duke u zhvilluar në bazë të nenit 25 të Ligjit nr. 06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 10/03, prill 2019).

Andaj, duke u bazuar në dispozitat ligjore të cilat janë të përshkruar në pjesën hyrëse të këtij propozimi dhe në shkresat e lëndës, propozojmë që të bëhet këmbimi i pronës komunale me pronë private, siç është përshkruar në pikën II të dispozitivit të këtij propozimi.

Pjesë përbërëse të këtij vendimi janë:

- skica grafike,
- kopjet e planit dhe
- certifikatat e njësisë kadastrale.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-463/03-112363/21, më 16.06.2021

KRYESUESI I KUVENDIT
Agim Kuleta

